**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Samire Sahiti** | **15.08.2023** | **24.08.2023** | **2023/0583** |

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.08.2023, OE "WOOD CORPORATION L.L.C."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0583, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Rolle Mont."- Prishtinë, "Furnizmi me perde per nevojat e Klinikave te Qkuk-se" me nr. të prokurimit: "701-23-5278-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **33,980.00** €, më Nr. 2023/0583 i dt:14.08.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

## I. HYRJE

1. Autoriteti Kontraktues Qendra Klinike Universitare e Kosovës me datën 25.05.2023 ka hapur aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizmi me perde për nevojat e Klinikave të QKUK-së" Vlera e këtij e parashikuar e këtij aktiviteti të prokurimit ishte

33,980.00 Euro.

2. Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar tri elemente kryesore për operatorët ekonomik: (i) Katalogun, (ii). Referencat për punë të ngjashme dhe (iii). Mostrat e produkteve, duke përfshirë përder dhe mekanizmat.

3. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave ishte data 16.06.2023. Brenda afatit Wood Corporation LLC, ka dorëzuar ofertën dhe mostrat e produkteve sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Në po të njëjtën ditë është bërë edhe hapja e ofertave. Nga procesverbali shihet se nga pesë ofertat e dorëzuara, ajo e Wood Corporation LLC ishte oferta më e lirë.

4. Me datën 27.07.2023 kemi pranuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, nga ku kemi parë se jemi eliminuar si kinse kompani e papërgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit, për dy arsye ku thuhej se kinse mungonin referencat (raportet e pranimit dhe referencat) sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe se "Nuk janë ofruar mostrat e produkteve si janë kërkuar".

5. Wood Corporation LLC menjëherë ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare dhe ka vërejtur se nuk qëndrojnë asnjëra nga dy pikat e eliminimit. Kjo për shkak se me listë të kontratave dhe dëshmitë e tjera është dëshmuar se operatori ka një numër të madh të kontratave të natyrës së ngjashme, ku përfshiheshin edhe perde për shumeë klient si dhe mostrat jo vetëm se janë dorëzuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit, por të njëjtat ishin më kualitative dhe më të përshtatshme sesa ato të operatorit të rekomanduar për dhenie të kontratës.

Me datën 01.08.2023 Wood Corporation LLC ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim duke arsyetuar se të gjitha kushtet e dosjes janë plotësuar dhe se dokumentet dhe mostrat janë siç janë kërkuar në dosjen e tenderit me të gjithë mekanizmat dhe produkte anti bakteriale.

Me datën 01.08.2023 Wood Corporation LLC ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim duke arsyetuar se të gjitha kushtet e dosjes janë plotësuar dhe se dokumentet dhe mostrat janë siç janë kërkuar në dosjen e tenderit me të gjithë mekanizmat dhe produkte anti bakteriale.

Me datën 03.08.2023 Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar Kërkesën për rishqyrtim dhe ka lënë në fuqi vendimin e AK-së, duke u munduar të shpikë arsye të eliminimit, e që të njëjtat nuk janë në përputhje me raportin e vlerësimit të ofertave dhe Njoftimin mbi Vendimin e AK-se¨.

## II. AUTORITETI KONTRAKTUES KA VLERËSUAR OFERTAT NË KUNDËRSHTIM

**ME LIGJIN DHE KA ELIMINUAR OFERTËN MË TË LIRË**

Siç dëshmohet me dokumentet e ofertës së Wood Corporation LLC operatori ka dorëzuar një listë të gjatë të kontratave me operator privat dhe publik të cilat i ka realizuar si dhe një listë të kontratave në realizim e sipër e ku vlera e këtyre kontratave për furnizim me inventar (duke përfshirë edhe perdet) ishte disa miliona euro. Edhe po qe se kanë munguar referencat apo certifikatat e pranimit teknik, Autoriteti Kontaktues ka pasur për detyrë që në përputhje me Nenin 69 dhe 72 të Ligjit të Prokurimit të kërkoj sqarime shtesë nga Wood Corporation LLC. Si provë të ekzistimit të referencave Wood Corporation ofron një faturë të dorëzimit të inventarit për klientin Edilgraniti SHPK. Të tilla furnizime me perde ka në shumë kontrata të tjera si përshembull ajo me G-project, Komunën e Suharekes, Komunën e Prishtinës dhe shumë kontrata të tjera.

Për më tepër se si duhet vepruar në këto situata është sqaruar edhe në Udhëzuesin Nr. 001/2023 të Prokurimit Publik, përkatësisht faqe 40, Rregulli 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, ku thuhet në tabelë qartazi se mund të kërkohet informata sqaruase kur mungojnë referencat/certifikatat e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara.

Në anën tjetër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues thuhet se mostrat nuk janë dorëzuar ashtu siç janë kërkuar, pa dhënë asnjë sqarim se çka u ka munguar apo çka nuk ka qenë në përputhje me dosjen e tenderit kur janë dorëzuar mostrat e produkteve nga ana e Wood Corporation LLC. Rrjedhimisht kjo arsye e Autoritetit Kontraktues është e paqëndrueshme dhe e paligjshme, pasi që në rast se do të kishte patur shkelje të çfarë do lloji nga ana e Wood Corporation LLC, një gjë e tillë do të duhej të thuhej qartë në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Ne¨ vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim përmendet se perdet nuk janë antibakteriale dhe se mekanizmat nuk janë dorëzuar për të gjitha mjetet. Përshkak se kjo nuk qëndron si konstatim i kërkojmë ekspertit që të vizitoj autoritetin kontraktues dhe në vend të ngjarjes ne do ti elaborjomë se janë të gjitha pajisjet e kërkuar dhe mekanizmat e për të njëjtat po ashtu kemi edhe fotografi nga qasja në dokumente zyrtare ku për të dëshmuar pretendimet tona i kemi incizuar të gjitha pajisjet e dorëzuara. Sa i përket materialit antibakterial, kemi konfirmimin e prodhuesit të materialit të perdeve i cili e konfirmon se të njëjtat janë anti bakteriale.

uhet theksuar se Wood Corporation LLC është prodhues i inventarit duke përfshirë edhe perdet dhe se prodhimi sipas kërkesave të dosjes së tenderit është një punë të cilën si prodhues vendor mund ta bëjë pa asnjë problem dhe me cilësi më të lartë sesa është kërkuar.

Andaj, duke marrë parasysh të gjitha provat dhe pretendimet e cekura si më lartë me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe administrimit të të gjitha provave të lëndës të nxjerr këtë:

**V E N DI M**

I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e operatorit

ekonomik Wood Corporation LLC.

II. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 26.07.2023 i publikuar me datën 27.07.2023 dhe lënda kthehet në **RISHQYRTIM**.

KRITERET PËR VLERËSIM

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 2. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi te listën e kontratave te natyrës se ngjashme me ni referencë ose raport pranimi.** | **Evidenca 2. Operatori Ekonomik ofertues duhet qe ofroj si dëshmi një liste te kontratave te realizuara te natyrës se ngjashme ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontratë, te përcjellura me ni referencë ose raport pranimi.** |
| **Kërkesa 3. Mostra te materialeve ( perdeve dhe mekanizmit ) Mostra te perdeve antibakteriale dhe profileve metalike-aluminit(mbajtesve dhe shiritit) mostrat duhet te dorezohen para hapjes se ofertave.** | **Evidenca 3. Operatori Ekonomik ofertues duhet qe te ofroj dëshmi Mostra te materialeve ( perdeve dhe mekanizmit ) Mostra te perdeve antibakteriale dhe profileve metalike-aluminit(mbajtesve dhe shiritit) mostrat duhet te dorezohen para hapjes se ofertave.** |

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni vlerësues ka rekomandur si tenderues te suksesshëm Rolle Mont-Prishtinë me cmim 28,075.00 euro.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Lidhur me mostrat dhe arsyen e eleminimit kemi kërkuar sqarim edhe nga AK edhe OE përmes opsionit në platformë sqarime shtesë, por të njëjtit nuk janë përgjigjur, meqë nuk kemi pranuar ndonjë konfirmim nga asnjëra palë, për të shmangur cdo paqartësi/përfshirë problemet e mundëshme teknike, rekomandojmë që mostrat apo dëshmitë lidhur me mostrat ti ofrohën panelit shqyrtues.

## Kërkesat për sqarime

### Kërkesat e dërguara

| Teksti i dërguar | Dërguar tek | Përgjigja |
|---|---|---|
| Te nderuar, Ju lutem mi dergoni deshmite lidhur me mostra... | Operatori Ekonomik | / |
| Te nderuar, Lidhur me kete ankese, a keni mundesi te me j... | Autoriteti Kontraktues | / |

### Kërkesë për sqarime të reja

Lloji i sqarimit

-- ZGJEDH --

Dërgo tekstin

Krijo

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **WOOD CORPORATION L.L.C.**

Sa i përkëtë pretendimit ankimor "Siç dëshmohet me dokumentet e ofertës së Wood Corporation LLC operatori ka dorëzuar një listë të gjatë të kontratave me operator privat dhe publik të cilat i ka realizuar si dhe një listë të kontratave në realizim e sipër e ku vlera e këtyre kontratave për furnizim me inventar (duke përfshirë edhe perdet) ishte disa miliona euro. Edhe po qe se kanë munguar referencat apo certifikatat e pranimit teknik, Autoriteti Kontaktues ka pasur për detyrë që në përputhje me Nenin 69 dhe 72 të Ligjit të Prokurimit të kërkoj sqarime shtesë nga Wood Corporation LLC. Si provë të ekzistimit të referencave Wood Corporation ofron një faturë të dorëzimit të inventarit për klientin Edilgraniti SHPK. Të tilla furnizime me perde ka në shumë kontrata të tjera si përshembull ajo me G-project, Komunën e Suharekes, Komunën e Prishtinës dhe shumë kontrata të tjera"

**Përgjigje:** OE ka dorëzuar listë të gjatë te kontratave por as në kontrata as në referenca nuk ka informacione nëse janë për perde, megjithse ka deshmi për furnizim me invertar për të konfirmuar se këtu ka edhe perde AK është dashur të kërkojë informacioneu shtesë, pasi ndaras prej listës dhe kontratave ka edhe foto të perdeve që janë bashkangjitur me rastin e ofertimit.

Kontrata me komunën e Prishtinës e cila është e bashkangjitur është me datë të përfundimit 21.11.2023 që i bie që nuk është e përfunduar. Pretendimi është pjesërisht i bazuar megjithatë, meqë AK nuk ka kërkuar vlerë të kontratave të realizuar është dashur të kërkojë sqarime dhe deshmi nëse përfshihën perdet pasi kontratat janë furnizim me invertar dhe nuk janë të specifikuar se cfarë invertari është furnizuar.

Ndërsa, sa i përketë pretendimit tjetër ankimor lidhur me "Në anën tjetër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues thuhet se mostrat nuk janë dorëzuar ashtu siç janë kërkuar, pa dhënë asnjë sqarim se çka u ka munguar apo çka nuk ka qenë në përputhje me dosjen e tenderit kur janë dorëzuar mostrat e produkteve nga ana e Wood Corporation LLC. Rrjedhimisht kjo arsye e Autoritetit Kontraktues është e paqëndrueshme dhe e paligjshme,

pasi që në rast se do të kishte patur shkelje të çfarë do lloji nga ana e Wood Corporation LLC, një gjë e tillë do të duhej të thuhej qartë në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim përmendet se perdet nuk janë antibakteriale dhe se mekanizmat nuk janë dorëzuar për të gjitha mjetet. Përshkak se kjo nuk qëndron si konstatim i kërkojmë ekspertit që të vizitoj autoritetin kontraktues dhe në vend të ngjarjes ne do ti elaborjomë se janë të gjitha pajisjet e kërkuar dhe mekanizmat e për të njëjtat po ashtu kemi edhe fotografi nga qasja në dokumente zyrtare ku për të dëshmuar pretendimet tona i kemi incizuar të gjitha pajisjet e dorëzuara. Sa i përket materialit antibakterial, kemi konfirmimin e prodhuesit të materialit të perdeve i cili e konfirmon se të njëjtat janë anti bakteriale"

**Përgjigje:** Lidhur me këtë pretendim kam kërkuar sqarime nga AK dhe OE përmes platformës tek sqarime shtesë por nuk kam pranuar ndonjë përgjigje, AK në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ka treguar arsyet lidhur me mostrat, megjithatë lidhur me këtë pretendim nuk kam mundesi të jap ndonjë rekomandim nëse është i bazuar apo jo, por rekomandoj që për te shmangur cdo paqartësi të ofrohën dëshmitë lidhur me mostra për panelin shqyrtues dhe më pastaj të mund të merrët veprimi i duhur.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **WOOD CORPORATION L.L.C.**

**Samire Sahiti**